

VENDIM
Nr.787, datë 26.11.2004

**PËR BASHKIMIN NË NJË TË VETME TË ZYRAVE TË REGJISTRIMIT TË PASURIVE
TË PALUAJTSHME “TIRANA 1” DHE “TIRANA 2” DHE PËR KRIJIMIN E ZYRAVE TË
REGJISTRIMIT TË PASURIVE TË PALUAJTSHME, TIRANË DHE HAS, SI DHE PËR
DISA NDRYSHIME NË VENDIMET E KËSHILLIT TË MINISTRAVE NR.243, DATË
26.3.2004, NR.303, DATË 16.4.1996, NR.676, DATË 14.10.1996 DHE NR.157,
DATË 26.2.1998**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 2, 56 dhe 57 të ligjit nr.7843, datë 13.7.1994 “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme”, të ndryshuar dhe të neneve 7 e 8 të ligjit nr.9165, datë 23.12.2003 “Për Buxhetin e Shtetit të vitit 2004”, me propozimin e zëvendëskryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Bashkimin në një të vetme të zyrave të regjistrimit të pasurive të paluajtshme “Tirana 1” dhe “Tirana 2” dhe krijimin e funksionimit të zyrës së regjistrimit të pasurive të paluajtshme, Tiranë.
 2. Krijimin dhe funksionimin e zyrës së regjistrimit të pasurive të paluajtshme, Has, me seli në Krumë.
 3. Kryeregjistruesi i Pasurive të Paluajtshme të Republikës të marrë masat për sigurimin, transportimin dhe sistemin e dokumentacionit përkatës në zyrën e regjistrimit të pasurive të paluajtshme, Tiranë dhe zyrën e regjistrimit të pasurive të paluajtshme, Has.
 4. Këshilli i qarkut të Kukësit të marrë masa për sigurimin e mjediseve për funksionimin e zyrës së regjistrimit të pasurive të paluajtshme, Has.
 5. Në vendimin nr.243, datë 26.3.2004 të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e numrit të punonjësve në ministritë dhe institucionet buxhetore, për vitin 2004 dhe për rishpërndarje fondesh buxhetore”, në lidhjen nr.1, që i bashkëlidhet këtij vendimi, numri i punonjësve buxhetorë për sistemin e regjistrimit të pasurive të paluajtshme, nga “242 veta” të bëhet “274 veta”.
 6. Në pikën 1 të vendimit nr.303, datë 16.4.1996 të Këshillit të Ministrave “Për çeljen dhe fillimin e punës së zyrave të regjistrimit të pasurive të paluajtshme në disa rrethe”, emërtimi “Tiranë” shfuqizohet.
 7. Në pikën 1 të vendimit nr.676, datë 14.10.1996 të Këshillit të Ministrave “Për fillimin e punës së zyrave të regjistrimit të pasurive të paluajtshme në disa rrethe të vendit”, emërtimi “Tirana 2” shfuqizohet.
 8. Në pikën 2 të vendimit nr.157, datë 26.2.1998 të Këshillit të Ministrave “Për fillimin e punës së zyrave të regjistrimit të pasurive të paluajtshme në disa rrethe”, emërtimet “Has” dhe “Kukës” shfuqizohen.
 9. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, të përballohen nga buxheti i miratuar për vitin 2004, për sistemin e regjistrimit të pasurive të paluajtshme.
 10. Ngarkohen Ministri i Financave, Ministri i Pushtetit Vendor dhe i Decentralizimit dhe Kryeregjistruesi i Pasurive të Paluajtshme të Republikës për zbatimin e këtij vendimi.
- Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano